



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:027504  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05637076

KPPP.nr.157/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit Prince Coffee House Sh.P.K.,-Njësia Nr.6 Prince Coffee House Bankos, me NRB: 811251595, me adresë Sheshi Skënderbeu në Pejë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.333/23 të datës 08.12.2023, të Përmbartuesit Privat Zija Bala me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 04.04.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Prince Coffee House Sh.P.K.,-Njësia Nr.6 Prince Coffee House Bankos, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.333/23 të datës 08.12.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, me datë 08.12.2023, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.333/23, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.190/23 të datës 31.05.2023, me të cilin është obliguar debitori që në afatin ligjor të paguaj shumën prej 1,500.00 Euro me kamatë ligjore duke filluar prej datës 31.05.2023 deri në pagesën përfundimtare, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se urdhri është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të LPP-së, dhe atë nenin 27 par.1. Më tej ka theksuar se Përmbaruesi Privat urdhrin të përmbarimit i ka bashkangjitur vendimet Nr.455/23 të datës 12.10.2023 dhe vendimin Nr.190/23 të datës 31.05.2023, të cilat vendime nuk përmbajnë asnjë nga tiparet e dokumentit përmbarimor dhe se vendimet nuk e kanë vulën e ekzekutueshmërisë, pra vendimi i kreditorit nuk e ka fuqinë e ekzekutimit të gjobës në procedurë përmbarimi. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit si i themeltë ndërsa të anulohet urdhri përmbarimor i lejuar nga Përmbaruesi Privat, si dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë procedurë dhe pasojat juridike që i ka prodhuar urdhri i lartcekur.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Me nenin 22 të LPP-së, në paragrafin 1 nënparagrafin 2 është përcaktuar se dokumente përmbaruese janë *“vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative...”*. Gjithashtu neni 23 paragrafi 2 i LPP-së ka përcaktuar se *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”*, kurse neni 24 paragrafi 3 i LPP-së ka paraparë se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin e Inspektoratit të Punës Nr.190/23 të datës 31.05.2023, në bazë të së cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Vendimi Nr.190/23 i datës 31.05.2023, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi Nr.190/23 i datës 31.05.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Vendimi Nr.190/23 i datës 31.05.2023, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është dorëzuar në origjinal, si dhe është bërë i ekzekutueshëm, fakt që vërtetohet nga klauzola e përmbarueshmërisë në vendimin e lartcekur, dhe nga Vendimi Nr.protokolli 455-03 i datës 12.10.2023, me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e debitorit dhe është vërtetuar vendimi nr..190/2023 i datës 31.05.2023 i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës.

Andaj, meqenëse në këtë çështje përmbarimore gjykata vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues sipas dispozitave të zbatuara ligjore, nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.157/24 me datë 05.04.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.